



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T
të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
24.07.2014, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Halim Halimi, kryesues i Komitetit, anëtarët: Sami Hamiti, Hazir Borovci, Ylli Hoxha, Hatixhe Hoxha, Islam Pacolli, Cuneyd Ustaibo dhe Imer Rusinovci.

Morën pjesë edhe: Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore, përfaqësuesi i INPO-së, përfaqësues të OSBE –së dhe Muhamet Selmani, në cilësinë e vëzhguesit, përfaqësues nga subjekti politik i PDK-së.

Mbledhjen e kryesoi dhe e udhëhoqi **Halim Halimi**, kryesues i Komitetit.

Njëzëri u miratua ky

REND DITE:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt;**
- 2. Propozimraporti për situatën ekonomike - financiare dhe për zbatimin e planeve investive të Komunës për periudhën janar - qershor të vitit 2014;**
- 3. Propozimraporti tremujor financiar, për periudhën prill - qershor të vitit 2014;**
- 4. Informatë për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet;**
- 5. Informatë për korrje - shirjet;**
- 6. Obligimet ligjore për komunat që dalin prej ligjeve të vitit 2009 - 2013;**
- 7. Diskutim për çështjen e qenve endacakë;**
- 8. Të ndryshme.**

Para se të fillonin me diskutimin e pikave të rendit të ditës, Kryetari, **Shpend Ahmeti**, tha se pika e dytë dhe e tretë e rendit të ditës janë obligime që rrjedhin nga dy ligjeve, andaj propozoj që për të dy pikat diskutimi të bëhet i njëjtë.

Ylli Hoxha propozoi që, në bashkëpunim me grupet parlamentare, të bëhet një deklaratë e përbashkët në shenjë proteste, që konsiderojmë se është edhe shqetësuese, për reduktimin e buxhetit të Komunës nga niveli qendror.

Pika e parë

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë dhe e tretë

Lidhur me Propozimraportin për situatën ekonomike - financiare dhe për zbatimin e planeve investive të Komunës për periudhën janar - qershor të vitit 2014, Kryetari shprehu mendimin se në këtë material duhet të jetë vetëm raporti i punës së drejtorive, mos të jenë edhe përshkrimet.

Sami Hamiti theksoi se këto dy raporte kryesisht ndërlidhen me punën e Kryetarit. Në këtë raport ka shumë përshkrime, e që nuk do duhej të ishin, është dashtë të përfshihet edhe Zyra e prokurimit, si dhe një hyrje nga Kryetari rreth nivelit të arkëtimit të të hyrave nga tatimi në pronë.

Lidhur me shfrytëzimin e sipërfaqeve publike, tha se mjetet e bartura për këtë fushë nuk janë në normën që janë paraqitur. Në infrastrukturën lokale janë futur vetëm projektet e kontraktuara. Vërejtje bëri edhe te raporti i auditimit, se është dashtë të jepet një opinion se çka ka mundur të arrihet, synohet me kapacitetet që i ka. Do të duhej të ishte edhe raporti i buxhetit të vitit të kaluar, me qëllim që të krahasohet me raportin e këtij viti.

Ylli Hoxha tha se ky raport duhet të plotësohet me raporte shtesë të zyrave, por duhet të jetë edhe një përmbledhje e ekzekutivit. Krahas këtij raporti duhet të jetë edhe raporti i vitit 2013, me qëllim të krahasimit me raportin e këtij viti.

Ai propozoi që këto informata të azhurnohen në ueb-faqen e Komunës.

Islam Pacolli tha se do të ishte mirë që të arrijmë ta shpenzojmë buxhetin për projektet kapitale. E përkrahu Kryetarin për marrjen e iniciativës për ngritjen e cilësisë së punës të auditorit të brendshëm të Komunës.

Sa i përket ruajtës së pronave komunale, ai tha se është koha për veprim, që në këto prona të mos lejohen ndërtime dhe të ruhen.

Imer Rusinovci bëri vërejtje në pjesën e Drejtorisë së Ekonomisë, duke kërkuar që tabelat 1.1, 1.4 dhe 1.8 të jenë më të sqaruara.

Muhamet Selmani, në cilësinë e vëzhguesit, dha këto vërejtje dhe sugjerime:

Kërkoj që të jetë një informim më i saktë rreth disa projekteve; arkëtimi i mjeteve nga lejet e ndërtimit është tejet shqetësues; te shpenzimet kapitale, shihet se është një trend i ulët; Zyra e auditimit duhet të kompletohet me staf më cilësor; duhet të sqarohen disa kërkesa rreth riparimit të shkollave; për regjistrimin e nxënësve në shkolla, propozoi që me prioritet të jenë vendasit, por edhe regjistrimi në çerdhe; për subvencionet, kërkoj që të detajizohen

se në cilat fusha janë ndarë ato; të jetë një databazë për nxënësit dhe studentët, si dhe një evidencë rreth pronave të Komunës.

U konstatua se njëzëri u përkrahën Propozimraporti për situatën ekonomike - financiare dhe për zbatimin e planeve investive të Komunës për periudhën janar - qershor të vitit 2014 dhe Propozimraporti tremujor financiar, për periudhën prill - qershor të vitit 2014, dhe i dërgohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e katërt

U konstatua se njëzëri u përkrah Informata për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e pestë

U konstatua se njëzëri u përkrah Informata për korrje - shirjet dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e gjashtë

U konstatua se njëzëri u përkrah zbatimi i obligimeve ligjore për komunat që dalin prej ligjeve të vitit 2009- 2013, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e shtatë

Lidhur me çështjen e trajtimit të qenve endacakë, Kryetari tha se nga Kuvendi do të kërkojë që ta bëjmë një diskutim publik, për ta analizuar mundësinë se si të veprohet për trajtimin e tyre.

U konstatua se njëzëri u përkrah diskutimi për çështjen e qenve endacakë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tetë

Të ndryshme.

Kryetari i njoftoi të pranishmit lidhur me kulmin e sallës së Kuvendit, i cili kishte pikur gjatë shirave të fundit që ranë, e që duhet intervenuar për rregullimin e tij. Për nder të muajit të Ramazanit, Kryetari i ftoi të pranishmit në iftar, i cili do të shtrohet në objektin e ri të Komunës.

Mbledhja përfundoi në orën 16:00.

**Procesmbajtës
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi, jur.i dipl.**